

URDHËR
Nr. 137, datë 25.2.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 99, DATË 10.2.2021 “PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDË VENDIT”

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, geramat “d”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809/4, datë 25.2.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021 “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrin togfjalëshi “deri në datën 25.2.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në një urdhër të dytë”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu